

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Foshnja e porsalindur humb jetën pas lindjes, 22 punonjës shëndetësorë nën hetim! Top Albania Radio
ADRESA	https://www.topalbaniaradio.com/foshnja-e-porsalindur-humb-jeten-pas-lindjes-22-punonjës-shendetesore-nen-hetim/
BURIMI	topalbaniaradio.com
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	25 shtator 2026, 08:37:09 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	25 shtator 2026, 08:26:18 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b178d2c6ec5b046b09fbfc5e27988346d0eb587a4aa4b85c52bc8f2f143baf3a
TEKSTI	7d72a5017859d620778a3816a3e0e86c528c35bdbbb1954ed44ad5dd9c852a30
PAMJA	11f85f046914442ef2407866f9d1b2176fa2d99d1a688fa50ac668801401b710

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	395da8b93b94a0df48eb7c70f5672db93f7d43461dffcae83708166c6e1b0a52
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	8b8efb9319bb60e287a9053a50eed732645594d6e8c6608cdf651dfbc0b1533
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/395da8b93b94a0df48eb7c70f5672db93f7d43461dffcae83708166c6e1b0a52>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px



Bota

Foshnja e porsalindur humb jetën pas lindjes, 22 punonjës shëndetësorë nën hetim!



Marisa Karabeci

25 Shtator 2026



TOP ALBANIA RADIO

BBC NEWS

Një foshnjë e porsalindur ka humbur jetën vetëm pak orë pas ardhjes në jetë në Itali, ndërsa Prokuroria e Perugia-s ka nisur hetimet ndaj 22 punonjësve shëndetësorë të spitaleve të Foligno-s dhe Perugia-s. Foshnja, i quajtur Pietro nga prindërit, lindi më 16 shtator në spitalin e Foligno-s, pas një lindjeje që, sipas të dhënave paraprake, u shoqërua me komplikacione dhe përfundoi me përdorimin e vakumit obstetrikal. Në orët pas lindjes, gjendja e tij shëndetësore u përkeqësua dhe mjekët vendosën transferimin urgjent drejt repartit të terapisë intensive në spitalin Santa Maria della Misericordia në Perugia.

Foshnja mbërriti në spital në gjendje shumë të rëndë. Pavarësisht përpjekjeve të mjekëve specialistë, ai nuk mundi të mbijetonte. Pas vdekjes, prindërit kanë bërë kallëzim në polici, duke kërkuar të zbardhen shkaqet e humbjes së foshnjës dhe të verifikohet nëse procedurat mjekësore janë ndjekur siç duhet. Prokuroria e Perugia-s ka sekuestruar kartelat mjekësore të dy spitaleve dhe ka identifikuar 22 mjekë dhe infermierë që kanë marrë pjesë në kujdesin ndaj nënës 32-vjeçare dhe foshnjës.

Punonjësit shëndetësorë janë regjistruar nën hetim me dyshimin për vrasje nga pakujdesia, por deri tani nuk është përcaktuar asnjë përgjegjësi individuale. Hetimi do të përfshijë të gjithë procesin e asistencës mjekësore, nga menaxhimi i lindjes në Folinjo, te gjendja e foshnjës në orët pas lindjes, vlerësimet klinike, vendimi për transferimin në Perugia, transporti dhe trajtimi në terapinë intensive neonatale. Ekspertiza e dokumentacionit mjekësor, së bashku me autopsinë, pritet të ndihmojë në përcaktimin e shkaqeve të vdekjes. Vetëm pas përfundimit të këtyre verifikimeve do të mund të përcaktohet nëse bëhej fjalë për komplikacione të pashmangshme apo nëse mund të ketë pasur përgjegjësi profesionale.

LAJME TË NGJASHME



Eskursioni shkollor kthehet në tragjedi, vdes mësuesja dhe një nga nxënësit!

1 MIN



ZI në futbollin turk, shuhet në moshën 25-vjeçare Tolga Kalender!

1 MIN



U ngjit në shtyllën e tensionit të lartë për trendin e rrezikshëm/Vogëlushja goditet nga 30 mijë volt!

2.5 MIN



Italia ndalon burkën në shkolla/Kufizime edhe për nxënësit e huaj në klasa!

1.5 MIN



Trump priti Xi-në në Shtëpinë e Bardhë/ Mesazhe bashkëpunimi, por pak rezultate konkrete!

1.5 MIN

MË TË LEXUARAT



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...



GJKKO konfirmon masën e sigurisë për Vlorë Hysenin!



Misteri i vdekjes së Maradonës merr kthesë të re, reagon eksperti dhe jep lajmin e hidhur!



U plagos pas konfliktit në Tiranë, një 49 vjeçar ndërroi jetë në spital!



4 suplemente që nuk duhet t'i merrni kurrë me ilaçet për tensionin e lartë!



"E kam nisur nga terreni, më pëlqen më shumë..." /Gazetarja Trevisa Tufa: Kur të jetë mundësia më e mirë në kohën e duhur...



Parkim me pagesë nga 5 tetori në Durrës, ja sa do të paguajnë qytetarët dhe çfarë përfitojnë rezidentët



Njihuni me ishullin ku derrat notojnë me turistët!




Ish-banorja e "BBV", Amber surprizon me transformimin e ri/FOTO!



Seriali kriminal që po çmend Netflix-in, 12.2 milionë shikime në vetëm katër ditë? Cili është?

EDITORI SUGJERON





Kuqezinjtë nisin misionin e ri në Nations League, të gjitha emocionet live dhe ekskluzivisht në DigitAlb!



Pse na mungon dikush më shumë gjatë natës? Ja çfarë mund të fshihet pas kësaj ndjesie...



Mund t'u mungosh shumë, por mesazhin mos e prit! 3 shenjat e horoskopit që nuk bëjnë kurrë hapin e parë...



Fenomeni "pocketing"/ Kur partneri të mban sekret dhe askush në jetën e tij nuk e di që ekziston...



Pse disa njerëz ecin nëpër shtëpi ndërsa flasin në telefon? Arsyeja pse e bëjnë këtë pa e kuptuar është...



"Goca dhe Gra" rikthehet në ekranin e Top Channel me ndryshime, kush janë moderatorët e sezonit të ri?



"Vetëm 1.8 kg, dyditëshe dhe..."/ Prof. Dr. Altin Veshti zbulon operacionin e jashtëzakonshëm në zemër që ka kryer!



Kur duhet operuar zemra? Prof. Dr. Altin Veshti zbulon rastet kur stentet (unazat) nuk janë më zgjidhje për pacientin...



Kivi apokumbullave të thata! Cila është më e mirë për tretjen?



"Kam operuar një 41-vjeçar me bypass..."/ Prof. Dr. Altin Veshti për infarktet: Moshë po ulet gjithmonë e më shumë!

RRETH NESH

Top Albania Radio promovon muzikën më të zgjedhur shqiptare dhe të huaj, me edicionet informative dhe një larmi programesh kulturore. 27 vjet transmetim, për të dhënë më të mirën.

KONTAKT

Address: Sheshi Italia 1, Arena Center, Tirana, Albania
Email:

Tel: +355 69 208 0500
+355 69 442 8873

COPYRIGHTS

Përmbajtja e këtij website është pronë e Top Albania Radio. Kopjimi, përdorimi apo riprodhimi i paautorizuar i tij, përbën shkelje penale.

LINKS

Kontaktimi
Marketing
Frekuencat
Aksesueshmëria
Mundësi Punësimi
Privacy Policy & Terms

JavaScript is required for [tabnav](#) widget to work properly.

Pamja këtua është e ri-koduara për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.